



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:046994  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05731960

**PA1.nr.737/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësorë Visar Gashi si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B.K nga O, për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 323 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesës së mbrojtëses së të pandehurit, av. M.R, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.176/23, i datës 20.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen** si të pabazuar ankesat e Prokuroria Themelore në Gjilan dhe ankesa e mbrojtëses së të pandehurit B.K, av. M.R, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr. 176/2023, i datës 20.03.2023, Vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore Gjilan, me aktgjykimin, P.nr.176/23, i datës 20.03.2023, të akuzuarin B.K, e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale mashtrimi, nga neni 323 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit B.K, dënimi i shqiptuar me burgim i ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë në shumën prej 1400.00 (njëmijekatërqind- euro), si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind-euro), të cilat dënim i njëjti është i obliguar ti paguajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i pandehuri B.K, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë

burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë. Në bazë të nenit 79 të KPRK-së të pandehurit të lartcekur, koha e kaluar në paraburgim nga data 21.02.2023, deri më 20.03.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim i llogaritet me 20 (njëzet) €, të gjobës. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 25 € (njëzetë e pesë- euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të pandehurit ti shqiptohet dënim kumulativ më të lartë me gjobë ose me burgim efektiv.

Mbrojtësja e të akuzuarit B (S) K me av. M.R, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën e mbrojtësit si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më ulët apo çështjen ta kthej në rigjykim në shkallën e parë.

Përgjigjeje në ankesën e Prokuroria Themelore në Gjilan ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit av. M.R, duke kundërshtuar pretendimet e Prokurorisë, me konstatimin se gabimisht i është referuar nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me konstatimin se gjykata nuk nenit 72 paragrafin 1, nën paragrafët 1.6 dhe 1.8 të KPK-së, sepse po të zbatoheshin këto dispozita do duhej të shqiptohej një dënim më i butë, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzoj ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan si të pa bazuar dhe Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet sipas pretendimeve të mbrojtësit të palës së akuzuar.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.772/2023 të datës 19.06.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm dhe të refuzohet ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesat janë të pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Prokuroria Themelore në Gjiilan e ankimon aktgjykimin për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se gjykata nuk i ka shqiptuar të akuzuarit dënim të merituar sipas ligjit, sepse këtë dënim e zbuti deri në atë masë që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit si dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuara me nenet 69, 70, të KPRK-së. Gjykata lidhur me rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit, nuk ka përmendur asnjë rrethanë lehtësuese apo rënduese në të cilat duhet të bazohet për shpalljen e të pandehurit fajtor dhe shqiptimit të sanksioneve penale-lartësinë e sanksioneve të shqiptuara, duke mos dhënë shpjegime të nevojshme dhe të domosdoshme se cilat rrethana do të duheshin të merreshin parasysh në rastin e shqiptimit të dënimit, për arsytet e numëruara si më lart dhe me qëllim të luftimit efikas të kriminalitetit ka propozuar që aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet or, ashtu që të pandehurit të lartpërmendur t'i shqiptoj dënim kumulativ më të lartë, me gjobë dhe me burgim efektiv, në mënyrë që sanksioni i shqiptuar penal të jetë proporcional me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara me veprën e kryer penale si dhe përgjegjshmërinë dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit B (S) K me av. M.R, e ankimon aktgjykimin për shkak të vendimit lidhur me sanksionit, duke pretenduar se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është i lartë, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e kësaj çështje penale e në veçanti duke marrë parasysh se i pandehuri i ka fajësinë që nga marrja në pyetje pranë Stacionit Policor në Gjiilan, gjatë fazës së hetimeve dhe po ashtu dhe gjatë shqyrtimit fillestarë. Gjykata, me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese ka numëruar disa rrethana, por përkundër faktit se i ka numëruar këto rrethana, megjithatë gjykata nuk i ka vlerësuar dhe peshuar drejtë këto rrethana lehtësuese sepse konsiderojmë se është dashur ti vlerësoj me ndryshe dhe rrjedhimisht të shqiptonte një dënim më të butë dhe më të favorshëm për të pandehurin. Si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë pranimin e fajësisë nga i akuzuari qysh në fazat e hershme të procedurës. Tutje si rrethanë lehtësuese gjykata ka marrë edhe pendimin e të akuzuarit që ishte pendim i qartë dhe i sigurtë. Rrethanë tjetër lehtësuese gjykata ka marrë se se i pandehuri kishte sjellje të mira në gjykatë, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Përkundër se gjykata i ka numëruar këto rrethana lehtësuese nuk i ka vlerësuar drejtë, po ashtu edhe faktin se i mbrojturi im jeton me ndihmë sociale dhe kjo gjobë mjaft e lartë e shqiptuar nga gjykata do të rëndonte edhe më tepër sociale të familjes së tij ngase i njëjti ka 3 fëmijë dhe jetojnë në banesa të socialit në Obiliq. Prandaj, konsiderojmë se edhe me shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha rrethanave lehtësuese edhe me shqiptimin e një dënimi më të butë, do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe mbrojtësit të akuzuarit janë të pabazuara. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit nga

kryerja e veprës penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, andaj të pandehurit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka dhe i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e Prokurorisë Themelore në Gjilan, kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të ashpër. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.737/2023, më datë 23.05.2024**

**Procesmbajtësi,**  
Visar Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Ferit Osmani

---

Zyhdi Haziri

---